

Analizë e raporteve konsultative të

# ZRRE-SË PËR PËRSHTATJET VJETORE TË TË HYRAVE TË LEJUARA MAKSIMA (MAR) PËR VITIN TARIFOR 2025



**Autor:** Dardan Abazi

**Programi:** Zhvillim i Qëndrueshëm

**Publikuar:** Prill, 2025



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

#### **Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP**

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.



**Rockefeller  
Brothers Fund**  
Philanthropy for an Interdependent World

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondit të Vëllezërve Rockefeller (RBF). Mendimet dhe pikëpamjet e autorëve nuk shprehin ose pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të RBF.

---

## Përmbajtja

Hyrje.....	1
Konteksti kronologjik .....	2
Komente specifike .....	3
Raporti Konsultativ për Përshtatjet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU.....	3
Raport Konsultativ: Përshtatjet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT Viti relevant tarifor 2025.....	5
Raport Konsultativ Përshtatjet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH .....	11
Përfundime dhe Rekomandime .....	15

## Hyrje

Procesi i konsultimeve publike për përshtatjet vjetore të të hyrave maksimale të lejuara për ndërmarrjet e energjisë në tregun e rregulluar të Kosovës, i inicuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë), zhvillohet në një moment kritik për sektorin energjetik. Në këtë kontekst, duhet theksuar që ZRRë ka dështuar në sigurimin e transparencës së plotë të këtij procesi, duke e kufizuar konsultimin vetëm në raportet teknike të përshtatjes së të hyrave, pa bërë publik ndonjë propozim konkret mbi strukturën tarifore apo nivelin specifik të tarifave për konsumatorët. Kjo bie ndesh me obligimet ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, neni 27, që kërkon transparencë dhe pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimmarrjen tarifore.

Në komunikatën e 14 marsit 2025, ZRRë ka bërë një deklaratë të paqartë, duke paralajmëruar një rritje mesatare të tarifave prej rreth 15%, pa e bërë të qartë strukturën apo kategorizimin e kësaj rritjeje. Një qasje e tillë e paqartë dhe e paplotë e pamundëson debatin e informuar publik dhe kufizon mundësinë për kontribut efektiv nga ana e qytetarëve, konsumatorëve dhe shoqërisë civile.

Një element tjetër kritik në këtë diskutim është procesi i liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, që vazhdon të jetë problematik dhe jo transparent. Ky proces, i iniciuar që nga viti 2017 dhe i shtyrë disa herë në mënyrë arbitrare dhe pa kriter të qarta, tashmë është përcaktuar nga ZRRë për t'u vazhduar së zbatuari më 1 qershor 2025. Momenti i zgjedhur për shpalljen e këtij procesi në fillim të marsit 2025, që ndërlidhet ngushtë me procesin e përcaktimit të tarifave për konsumatorët e rregulluar, ngre pyetje serioze që kërkojnë sqarim. Në dokumentet e konsultimit mungon sqarimi i plotë mbi ndikimin e konsumatorëve që do të kalojnë në treg të lirë—konkretisht, sa do të ndikonte në rritjen e tarifave për konsumatorët e mbetur në shërbimin universal ky kalim dhe sa realisht po ndikojnë këta konsumatorë aktualisht në strukturën tarifore ekzistuese. Pavarësisht rëndësisë së liberalizimit për konkurrencën dhe zhvillimin e tregut, mënyra se si ky proces është menaxhuar nga ZRRë, me shtyrje dhe paqartësi të vazhdueshme, cenon rëndë besimin e konsumatorëve dhe aftësinë e tregut për t'u përshtatur në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme.

Ne mbështesim liberalizimin e tregut dhe një strukturë tarifore që nxit efikasitetin dhe kursimin e energjisë. Në vitin 2022, INDEP propozoi një strukturë tarifore me tri nivele konsumimi (deri në 600 kWh, 600-1200 kWh dhe mbi 1200 kWh), për të balancuar kostot dhe për të nxitur sjelljen konsumatore drejt kursimit të energjisë dhe investimeve në burime të ripërtëritshme. Për fat të keq, ZRRë nuk e ka marrë parasysh këtë propozim, duke implementuar një strukturë me vetëm dy blloqe konsumi (0-800 kWh dhe mbi 800 kWh), që ka potencial për të ndikuar negativisht në mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm dhe promovimin e kursimit. Ne konsiderojmë që ky është një rast i mirë që sërish të rikonsiderohet struktura tarifore, ashtu që të shpërndahet barra e shtrenjtimit tek shpenzuesit e mëdhenjë dhe jo tek konsumi esencial që rezulton me deri në 600 kWh.

Duke analizuar raportet e ZRRë-së, ne gjithashtu kemi shumë komente që ndërlidhen me mungesën e transparencës në arsyetimin e kostove, paqartësinë në përcaktimin e faktorëve të efiçencës, komente rreth kalimit automatik të kostove të larta tek

konsumatorët, si dhe paqartësi lidhur me metodat e parashikimit dhe korrektësinë e vlerësimeve të bëra. Të gjitha i kemi listuar në pjesën e komenteve specifike.

Prandaj, përmes këtij dokumenti, ne kërkojmë një transparencë më të madhe, rivlerësim të strukturës tarifore dhe një angazhim më efektiv të ZRrE-së për të garantuar pjesëmarrjen e plotë publike në vendimmarrje dhe për të siguruar që të drejtat e konsumatorëve mbrohen plotësisht.

Ky dokument është përgatitur në kuadër të programit të INDEP për zhvillim të qëndrueshëm dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e donatorëve që përkrahin punën e Insitutit.

### **Konteksti kronologjik**

Procesi i përcaktimit të tarifave të energjisë elektrike në Kosovë, si dhe liberalizimi i tregut të energjisë, janë përgjegjësi ligjore dhe rregullative të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE). Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë e ZRrE-së në këtë drejtim, duke e obliguar këtë institucion të sigurojë që tarifat e përcaktuara të jenë transparente, të justifikuar në mënyrë rigorozë, të reflektojnë kostot reale të shërbimit dhe të konsultohen publikisht me palët e interesit.

Në Kosovë, deri në vitin 2017, tarifat e energjisë elektrike kanë qenë të organizuara sipas një strukture bllok-tarifore që kishte për qëllim inkurajimin e kursimit. Kjo strukturë u ndërpre në vitin 2017, duke rritur konsumin dhe duke nxitur debat të theksuar publik. Duke e parë këtë, në janar 2022, ZRrE propozoi përsëri një strukturë tarifore me blloqe konsumi, ku përcaktohej kufiri i konsumit në 800 kWh, dhe parashikohej një rritje e konsiderueshme e tarifave për konsumin mbi këtë prag. Ky propozim ngjalli debate të shumta në opinionin publik dhe ekspertët e sektorit energjetik, përfshirë INDEP-in, i cili pati propozuar një strukturë alternative me tri shkallë konsumi, duke kërkuar një balancim më të drejtë dhe më realist të tarifave për konsumatorët – sidomos konsumatorët më të cenueshëm me nivel konsumi nën kufirin esencial prej 600 kWh. Kjo nuk u përfill dhe ZRrE zgjodhi sërish modelin deri në 800 dhe mbi 800.

Në anën tjetër, në janar të vitit 2017, ZRrE publikoi Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut, i cili parashihte kalimin gradual të konsumatorëve në tregun e lirë, duke filluar me konsumatorët industrialë dhe më pas ata komercialë në nivele të ndryshme të tensionit. Megjithatë, ky proces nuk u realizua sipas planifikimit fillestar, duke përjetuar shtyrje të përsëritura pa një shpjegim të qartë dhe pa kritere të mirëpërcaktuara se kur kushtet e tregut do të konsideroheshin të përshtatshme për liberalizim. Mungesa e një metodologjie transparente dhe të qartë çoi në një situatë ku liberalizimi mbeti një proces abstrakt, me afate të paqarta dhe që shkaktoi pasiguri për konsumatorët dhe bizneset.

Në shkurt 2025, ZRrE nisi një proces konsultimi publik në lidhje me përshtatjet vjetore të të hyrave maksimale të lejuara për ndërmarrjet e energjisë, ku u shfaqën kërkesa për rritje të ndjeshme të tarifave. Në fillim të marsit 2025, ZRrE doli me komunikatë për të njoftuar vendimin për të vazhduar me liberalizimin e tregut duke filluar nga 1 qershori 2025, duke i nxjerrë konsumatorët jo-shtëpiakë të një madhësie të caktuar

jashtë shërbimit universal. Koha e shpalljes së këtij vendimi, gjatë periudhës kur po zhvillohet konsultimi publik për përcaktimin e tarifave të reja, ngre dyshime mbi transparencën dhe qëllimin e këtij hapi, pasi nuk u ofrua asnjë analizë e qartë mbi ndikimin që largimi i këtyre konsumatorëve do të ketë mbi tarifën e konsumatorëve të mbetur.

Në datën 14 mars 2025, ZRrE publikoi raportin konsultativ mbi përshtatjet vjetore të të hyrave maksimale, duke përmendur në mënyrë jo-transparente dhe ambiguoze se tarifën mund të rriten mesatarisht rreth 15%, pa ofruar një strukturë të qartë tarifore ose një propozim konkret që do të mund të komentohej nga publiku.

Konteksti i procesit aktual të konsultimeve mbi tarifën energjetike është i karakterizuar nga një mungesë e vazhdueshme transparence, dështime në respektimin e afateve dhe kriterëve të liberalizimit, si dhe shqetësime serioze për mbrojtjen e konsumatorëve. Në këtë drejtim, analizat dhe rekomandimet tona synojnë të rrisin transparencën, të forcojnë përgjegjësinë institucionale të ZRrE-së dhe të garantojnë një qasje më të drejtë dhe realiste në përcaktimin e tarifave të energjisë.

## **Komente specifike**

### **Raporti Konsultativ për Përshtatjet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për FSHU**

#### **Komenti 1: Faktori i Efikasitetit të Kostove Operative (OPEX)**

Në Raportin Konsultativ, ZRRE ka përcaktuar që kostot operative (OPEX) të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU) për vitin tarifor 2025 të indeksohen me një faktor efikasiteti prej **0.75%**. Në dokument nuk ofrohet asnjë shpjegim metodologjik apo analizë e qartë se si është përcaktuar ky nivel efikasiteti. Vendimi **V\_2637\_2025**, i cili paraqitet si bazë për këto kalkulime, gjithashtu nuk ofron një arsyetim të detajuar lidhur me këtë figurë specifike.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij faktori dhe ndikimin e tij në përcaktimin e të hyrave të lejuara maksimale (MAR), INDEP kërkon nga ZRRE që:

- Të sqarojë në mënyrë transparente metodologjinë dhe kriteret e përdorura për përcaktimin e faktorit të efikasitetit prej 0.75%.
- Të ofrojë analizë ekonomike mbi realizueshmërinë e këtij faktori duke marrë parasysh kushtet aktuale ekonomike dhe operacionale në tregun e energjisë në Kosovë.
- Të argumentojë qartë nëse është realiste dhe e bazuar në evidenca objektive pritja që FSHU do të realizojë një rritje të efikasitetit prej 0.75%, veçanërisht në kushtet e paqëndrueshme ekonomike dhe energjetike të kohës.

Pa ofruar këto sqarime, vendosja e një faktori të tillë efikasiteti mbetet jotransparente, duke krijuar rrezik për mosrealizim dhe rrjedhimisht transferim të barrës së kostove shtesë tek konsumatorët përmes tarifave më të larta në vitet pasuese.

## Komenti 2: Sqarimi i pamjaftueshëm dhe mungesa e transparencës për Kostot e Bartshme dhe ndikimin e deregulimit

Në Raportin Konsultativ mbi Përshtatjet Vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU), kostot e bartshme paraqesin një pjesë të konsiderueshme të strukturës tarifore të propozuar nga ZRrE. Këto kosto, të cilat përfshijnë tarifën e OST/OT (KOSTT), OSSH (KEDS) dhe Fondit të Burimeve të Ripërtëritshme (BRE), janë përcaktuar duke u bazuar në sasi të furnizimit për konsumatorët e rregulluar dhe duke marrë parasysh efektin e procesit të deregulimit.

INDEP konstaton se Raporti nuk ka sqaruar në mënyrë të mjaftueshme dhe transparente:

- Si janë përcaktuar konkretisht këto kosto bartëse, dhe në çfarë mase është analizuar dhe vërtetuar që ato janë të justifikuara dhe të arsyeshme?
- Si ndikon specifikisht procesi i deregulimit të konsumatorëve në këto kosto, veçanërisht në aspektin e sasive dhe profilit të energjisë së blerë nga FSHU?
- Cilat kategori të konsumatorëve preken konkretisht nga ndryshimet, sa është vëllimi i konsumit të tyre dhe si ky ndryshim reflektohet në nivelin e tarifave për konsumatorët e mbetur në tregun e rregulluar?
- Cili është ndikimi afatmesëm dhe afatgjatë i deregulimit të konsumatorëve mbi këto kosto dhe mbi stabilitetin financiar të FSHU-së, duke marrë parasysh se deregulimi do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme?

Për këto arsye, kërkojmë që ZRrE të:

- Publikojë analizën e detajuar ekonomike dhe metodologjinë e përdorur në përcaktimin e kostove të bartshme për FSHU-në, duke demonstruar se këto kosto janë të justifikuara dhe të bazuara në kostot reale të shërbimeve.
- Ofroj qartë ndikimin e procesit të deregulimit në këto kosto, duke specifikuar qartë cilat të hyra preken, në çfarë mase dhe si këto ndikojnë në planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë të furnizimit me energji për konsumatorët e rregulluar.

Pa sqarimin e këtyre elementeve, konsumatorët nuk mund të jenë të informuar në mënyrë të mjaftueshme mbi arsyetimin e kostove që mbulojnë nga tarifën që ata paguajnë, duke cenuar kështu parimin e transparencës dhe llogaridhënies së detyrueshme ligjore për ZRrE-në.

## Komenti 3: Paqartësitë dhe mungesa e transparencës në përcaktimin e kostove të blerjes së energjisë me shumicë

Në kapitullin që trajton kostot e blerjes së energjisë me shumicë (WHPC) për vitin 2025, raporti identifikon disa çështje kritike lidhur me përshtatjen e çmimit të energjisë së blerë nga hidrocentralet me koncesion. Dokumenti vetë pranon se palët e përfshira kanë përdorur një qasje të ndryshme nga ajo e përcaktuar në Marrëveshjen për Shitblerjen e Energjisë (PPA), duke rezultuar në çmime që devijojnë nga propozimi fillestar. Si rrjedhojë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka aplikuar një korigjim

prej -0.45 milionë euro, duke vendosur shpërndarjen e kësaj vlere përgjatë tri viteve (-0.15 milionë euro në vit). Megjithatë, në dokument mungojnë sqarimet e duhura mbi arsyet që kanë çuar në këtë korrigjim, metodologjinë e zgjedhur për shpërndarjen trevjeçare të kësaj vlere, si dhe mbi ndikimet konkrete që ky korrigjim do të ketë në tarifën e konsumatorëve në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

INDEP konsideron se:

- Mungesa e transparencës lidhur me metodologjinë dhe arsyetimin e ndryshimit të qasjes për përshtatjen e çmimeve të energjisë nga hidrocentralet me koncesion cenon besueshmërinë e parashikimeve për kostot e blerjes së energjisë.
- Korrigjimi prej -0.45 milionë euro dhe shpërndarja e tij në tri vjet mund të rezultojë në transferimin e kostove shtesë tek konsumatorët, si pasojë e pasigurive dhe pasaktësive në procesin e parashikimit.
- Mosadresimi i këtyre paqartësive në mënyrë transparente dhe metodologjiksht të qartë rrit rrezikun që konsumatorët të paguajnë në tarifën e ardhshme për gabime parashikimi.

Për të adresuar këto shqetësime, INDEP rekomandon që ZRRE:

- Të sqarojë në mënyrë të detajuar dhe transparente pse është devijuar nga marrëveshja fillestare (PPA) dhe të publikojë metodologjinë e plotë që ka çuar në korrigjimin e vlerës prej -0.45 milionë euro.
- Të argumentojë qartë logjikën pas shpërndarjes trevjeçare të korrigjimit dhe të analizojë publikisht ndikimin financiar që ky vendim do të ketë tek konsumatorët.
- Të marrë masa për përmirësimin e proceseve të parashikimit dhe monitorimit, për të shmangur përsëritjen e pasaktësive të ngjashme në të ardhmen.

Në mungesë të këtyre masave, mbetet shqetësues rreziku që konsumatorët të vazhdojnë të mbulojnë në mënyrë të padrejtë barrën e kostove të shtuara për shkak të pasigurive në planifikimin e kostove të energjisë.

## **Raport Konsultativ: Përshtatjet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OST/OT Viti relevant tarifor 2025**

### **Komenti 4: Përdorimi i Indeksit të Inflacionit të Eurozonës (HICP) për indeksimin e kostove të lejuara**

Në Raportin Konsultativ, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka përdorur Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (HICP) të Eurozonës për indeksimin e kostove operative (OPEX), kostove të amortizimit dhe kthimit të lejuar për vitin 2025. Konkretisht, është përdorur shkalla e inflacionit prej 2.36%, e publikuar nga Eurostat për vendet e Eurozonës.

INDEP shpreh shqetësimin se:



- Kosova nuk është pjesë e Eurozonës dhe indeksi i inflacionit i Eurozonës mund të mos reflektojë me saktësi realitetin ekonomik lokal.
- Nuk është sqaruar në mënyrë të mjaftueshme arsyeja pse është zgjedhur pikërisht indeksi i inflacionit të Eurozonës dhe jo një indeks që më saktësisht reflekton kushtet ekonomike në Kosovë. ZRRE duhet të sqaroj nëse kjo përzgjedhje mbron interesin ekonomik të konsumatorëve në Kosovë apo jo!
- Përdorimi i një indeksi inflacioni të papërshtatshëm mund të ndikojë drejtpërdrejt në llogaritjen e tarifave, duke shkaktuar mbingarkesë ose nënvlerësim të kostove reale, që në afat të gjatë cenon qëndrueshmërinë financiare dhe transparencën në përcaktimin e tarifave.

Në këtë drejtim, INDEP rekomandon që ZRRE:

- Të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të një indeksi inflacioni që pasqyron më saktë realitetin ekonomik në Kosovë, siç është indeksi i çmimeve të konsumit i Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).
- Nëse vazhdon përdorimi i indeksit HICP të Eurozonës, atëherë të paraqesë në mënyrë transparente analizën dhe argumentimin ekonomik që justifikon përshtatshmërinë e këtij indeksi për kontekstin ekonomik dhe energjetik të Kosovës.

Në mungesë të një qasjeje më të përshtatshme dhe të argumentuar mirë, konsumatorët mund të jenë duke mbuluar në mënyrë jo të drejtë kosto shtesë të shkaktuara nga përdorimi i indeksit jo-reprezentativ për Kosovën.

#### **Komenti 5: Paqartësitë dhe mungesa e analizës së duhur ekonomike lidhur me rritjen e kostove të shërbimeve ndihmëse për vitin 2025**

Në kapitullin e Raportit Konsultativ që trajton shërbimet ndihmëse (**ancillary services**), ZRRE parashikon një rritje jashtëzakonisht të lartë të këtyre kostove për vitin 2025. Konkretisht, krahasuar me shpenzimet e realizuara në vitin 2024 (**24.7 milionë euro**) dhe kostot e lejuara nga ZRRE për të njëjtin vit (**18.17 milionë euro**), propozimi i ZRRE-së për vitin 2025 arrin në **43.12 milionë euro**, një rritje prej rreth **137%**. INDEP vëren se raporti jep disa arsye operationale dhe teknike për këto rritje, por nuk ofron analizë të mjaftueshme ekonomike dhe transparencë në procedurat e kontraktimit të këtyre shërbimeve.

Në veçanti, INDEP ka identifikuar këto mangësi:

##### *1. Kapaciteti i rezervës automatike (aFRR):*

Raporti sqaron se kapaciteti i rezervës automatike (aFRR) është rritur nga **±25 MW në ±40 MW** për shkak të:

- Nevojës për balancim më të mirë të sistemit;
- Observimeve të ENTSO-E për devijimet në sistemin e ndërlidhur evropian;
- Kërkesave rregullative.

Megjithatë, raporti **nuk jep një analizë të detajuar ekonomike për zgjedhjen e nivelit të ri të kapacitetit ±40 MW**, duke mos shpjeguar pse është zgjedhur pikërisht ky nivel dhe cili është ndikimi i tij ekonomik në strukturën e kostove. Gjithashtu, raporti sqaron që ky shërbim është siguruar ekskluzivisht përmes OST-së së Shqipërisë me anë të një ankandi javor, por nuk ofron:

- Arsyetim ekonomik pse ky kapacitet është kontraktuar vetëm nga OST-ja e Shqipërisë;
- Nëse janë konsideruar alternativa të tjera më ekonomike brenda tregut rajonal;
- Nëse ky proces tenderimi ka qenë i hapur dhe konkurrues në mënyrë të mjaftueshme për të siguruar çmimet më të favorshme për konsumatorët e Kosovës.

## *2. Rezerva manuale (mFRR):*

Raporti thekson se rezerva manuale (mFRR) për vitin 2025 është kontraktuar me KESH-in me kapacitete prej **+196 MW (lart) dhe -50 MW (poshtë)** për një shumë totale prej **14.62 milionë euro**, që paraqet një rritje prej **63%** krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa raporti deklaron që kjo kontratë është realizuar në bazë të procedurave të tenderimit, ai nuk jep detaje mbi:

- Transparencën dhe hapjen e këtij procesi tenderimi;
- Numrin e ofertuesve dhe kriteret e vlerësimit;
- Nëse OST/OT apo ZRRE kanë eksploruar opsione alternative ose kanë analizuar konkurrencën në treg për të minimizuar këtë rritje të kostove.

Kjo mungesë transparence dhe e analizës konkurruese ngre dyshime për efektivitetin e procesit të prokurimit dhe për potencialin e ngarkimit të konsumatorëve me kosto më të larta sesa ato që mund të arriheshin në një treg më konkurrues.

## *3. Analiza e munguar e faktorëve të çmimeve dhe impaktit në tarifaf afatmesme:*

Megjithëse raporti identifikon mekanizmat e përdorur për kontraktimin e shërbimeve ndihmëse (ankande javore për aFRR dhe tender për mFRR), ai nuk sqaron në mënyrë të detajuar:

- Cilët faktorë konkretë kanë kontribuar në përcaktimin e çmimeve për këto rezerva, përtej vetë procesit të ankandit apo tenderimit;
- Çfarë masash janë ndërmarrë për të kufizuar ndikimin e këtyre çmimeve në kostot e përgjithshme;
- Në çfarë mase këto rritje të konsiderueshme të kostove janë reflektuar në një analizë afatmesme për tarifaf finale që konsumatorët do të paguajnë, duke marrë parasysh vazhdimësinë e këtyre tendencave të rritjes.

## Rekomandimet e INDEP:

Duke marrë parasysh këto gjetje, INDEP rekomandon që ZRRE të ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- Të publikojë një analizë ekonomike dhe teknike të detajuar që justifikon qartë zgjedhjen e kapacitetit prej  $\pm 40$  MW për rezervën automatike (aFRR), duke përfshirë arsyet e kontraktimit ekskluziv nga OST-ja e Shqipërisë.
- Të sqarojë procedurat e tenderimit për rezervën manuale (mFRR) të kontraktuar me KESH-in, duke treguar numrin e ofertuesve, kriteret e përzgjedhjes dhe të shpjegojë nëse janë konsideruar alternativa të tjera konkurruese për të shmangur rritjen prej 63% të kostove krahasuar me vitin paraprak.
- Të ndërmarrë hapa për të garantuar transparencë më të madhe në tenderime dhe prokurime të shërbimeve ndihmëse në të ardhmen, duke stimuluar konkurrencën dhe shmangur çdo rritje disproporcionale të kostove.
- Të përfshijë në analizat e ardhshme edhe impaktin afatmesëm dhe afatgjatë të rritjeve të tilla të kostove në tarifat finale për konsumatorët.

Në mungesë të masave të tilla korrigjuese, konsumatorët në Kosovë do të vazhdojnë të përballen me tarifa më të larta dhe potencialisht të pajustificuara plotësisht, duke u ekspozuar ndaj kostove që mund të ishin shmangur ose zbutur nëpërmjet një procesi më transparent, konkurrues dhe të analizuar mirë ekonomikisht.

### **Komenti 6: Paqartësitë metodologjike dhe mungesa e mekanizmave korrigjues lidhur me përdorimin e premiumit prej 9.55% në çmimet e importit të energjisë elektrike (HUPEX/ALPEX)**

Në kapitullin e tretë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) prezanton një shtesë (premium) prej **9.55%** në çmimet mesatare të energjisë elektrike të referencës HUPEX, e cila është përdorur për parashikimin e kostove të blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve të OST gjatë vitit 2025. Ky premium është bazuar në analizën e të dhënave historike të diferencës mes çmimeve të tregut njëditor të HUPEX dhe ALPEX, dhe ka rezultuar në një çmim mesatar të importit prej **105.70 €/MWh** për vitin 2025.

INDEP identifikon disa çështje kritike në këtë qasje:

#### *1. Paqartësia metodologjike në përcaktimin e premiumit prej 9.55%*

Raporti deklaron se ky premium prej 9.55% është kalkuluar në bazë të analizës së të dhënave historike të dallimit mes çmimeve të HUPEX dhe ALPEX. Megjithatë, në raport nuk janë sqaruar në mënyrë transparente:

- Periudha specifike kohore e analizuar për të nxjerrë këtë mesatare (përse nuk është marrë periudhë më e gjatë kohore e analizës);
- Metoda statistikore e përdorur për kalkulimin e kësaj mesatareje (p.sh., mesatare e thjeshtë, e ponderuar, analizë regresioni apo metoda tjetër);

- Nëse janë marrë parasysh dhe analizuar veçanërisht tendencat e fundit që tregojnë ulje të konsiderueshme të këtij dallimi (p.sh. nga 23% në shtator 2024 në 3% në shkurt 2025).

Mungesa e transparencës në përcaktimin e kësaj shifre dhe metodologjisë së përdorur dobëson besueshmërinë e kësaj qasjeje, veçanërisht duke marrë parasysh ndryshimet e konsiderueshme të fundit në tregjet rajonale të energjisë.

## *2. Mungesa e analizës së trendeve të ardhshme të diferencës së çmimeve (HUPEX/ALPEX)*

Ndërsa raporti përdor historikun për të aplikuar këtë premium në parashikimet e vitit 2025, nuk ofrohet asnjë analizë ose parashikim për ndryshimet e mundshme gjatë vitit të ardhshëm. Duke pasur parasysh se diferenca mes HUPEX dhe ALPEX është duke u zvogëluar në mënyrë të dukshme (23% në shtator 2024 në 3% në shkurt 2025), ky premium prej 9.55% mund të mos jetë i përshtatshëm për vitin 2025, duke rezultuar potencialisht në kosto më të larta dhe të padrejta për konsumatorët.

## *3. Mungesa e mekanizmave korrigjues dhe alternativave për skenarë të ndryshëm*

Raporti nuk ofron asnjë mekanizëm të qartë se si do të trajtohet situata në rast se diferenca reale gjatë vitit 2025 devijon në mënyrë të konsiderueshme nga shifra prej 9.55%. Në rast se diferenca rezulton më e ulët ose më e lartë nga ajo e aplikuar në parashikime, konsumatorët mund të përballen me tarifa të padrejta, duke u ngarkuar kështu me kosto shtesë të pajustificuara ose duke krijuar paqartësi financiare për OST/OT.

## *4. Mungesa e analizës së ndikimit afatmesëm dhe afatgjatë në tarifat e konsumatorëve*

Raporti nuk përmban asnjë analizë specifike lidhur me ndikimin afatmesëm dhe afatgjatë që ky premium prej 9.55% mund të ketë në tarifat finale që paguajnë konsumatorët. Duke qenë se kjo shtesë është një element i rëndësishëm në përcaktimin e kostove të importit, është thelbësore që ZRRE të ofrojë një analizë më të detajuar të impaktit afatgjatë në tarifat e konsumatorëve.

## **Rekomandimet e INDEP:**

Në mënyrë që të adresohen këto çështje, INDEP rekomandon që ZRRE të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- Të publikojë një sqarim të plotë metodologjik që përshkruan qartë periudhën historike dhe metodën statistikore që është përdorur për kalkulimin e premiumit prej 9.55%.
- Të kryejë një analizë shtesë për trendet aktuale dhe të pritshme të diferencës së çmimeve HUPEX-ALPEX gjatë vitit 2025 dhe të konsiderojë rishikimin e kësaj shifre për të reflektuar realitetin aktual të tregut.
- Të krijojë dhe prezantojë një mekanizëm korrigjues në mënyrë që në rast se çmimet reale devijojnë dukshëm nga premiumi i parashikuar, të mund të

kryhen korrigejme ex-post për të siguruar drejtësi dhe transparencë për konsumatorët.

- Të përfshijë në raport analizën e impaktit afatmesëm dhe afatgjatë që ky premium do të ketë në tarifat e konsumatorëve, për të shmangur implikime të paparashikuara negative për konsumatorët dhe stabilitetin financiar të sektorit të energjisë.

### **Komenti 7: Norma e lartë e interesit (9.05%) për llogaritjen e faktorit korrigjues të të hyrave (KREV) dhe mungesa e analizës për alternativa më të favorshme për konsumatorët**

Në seksionin 4 të Raportit, ZRRE trajton përshtatjet për faktorin korrigjues të të hyrave për vitin e realizuar 2024, duke aplikuar një normë interesi prej **9.05%** (EURIBOR 3.31% + premiumi 5.74%). Ky faktor korrigjues (KREV) arrin shumën prej **0.85 milionë euro**, që rezulton nga diferenca mes kostove të lejuara (54.24 milionë €) dhe të hyrave të realizuara (53.47 milionë €), duke përfshirë edhe interesin e aplikuar.

INDEP vëren disa çështje shqetësuese lidhur me këtë qasje dhe normën e interesit të aplikuar:

#### *1. Norma e lartë e interesit dhe implikimet për konsumatorët*

Aplikimi i një norme interesi prej **9.05%** (3.31% EURIBOR plus premiumi prej 5.74%) për përshtatjen e faktorit korrigjues përbën një kosto të konsiderueshme financiare që transferohet automatikisht tek konsumatorët. Raporti nuk përmban një analizë të detajuar që justifikon nevojën apo arsyeshmërinë e aplikimit të një premiumi kaq të lartë (5.74%) mbi normën EURIBOR.

Në mungesë të shpjegimeve shtesë, kjo normë interesi mund të interpretohet si një ngarkesë e tepërt për konsumatorët, veçanërisht duke marrë parasysh që diferenca prej 0.77 milionë € (para interesit) rritet në 0.85 milionë € pikërisht për shkak të kësaj norme interesi.

#### *2. Paqartësia mbi metodologjinë e përcaktimit të premiumit (S)*

Raporti sqaron se premiumi prej 5.74% është vendosur nga ZRRE gjatë shqyrtimit periodik për të reflektuar kostot e huave afatshkurtra. Megjithatë, raporti nuk ofron asnjë detaj specifik lidhur me:

- Metodologjinë dhe kriteret e përdorura për të përcaktuar këtë premium;
- Nëse janë konsideruar alternativa më të favorshme dhe ekonomike për konsumatorët gjatë përcaktimit të këtij premium;
- Nëse premiumi prej 5.74% është ende i përshtatshëm dhe i reflektueshëm i realitetit aktual të tregut financiar në Kosovë dhe Evropë.

### *3. Mungesa e alternativave dhe opsioneve më të favorshme për konsumatorët*

ZRRE nuk duket të ketë eksploruar alternativa më të favorshme ose më të ulëta në kosto për konsumatorët, për shembull:

- Mundësinë e aplikimit të një premium më të ulët, duke reflektuar realitetin aktual financiar të tregut;
- Mekanizma alternativë financiarë që mund të kishin reduktuar ngarkesën e kësaj norme interesi te konsumatorët.

### *4. Mungesa e analizës së impaktit afatgjatë në tarifat e konsumatorëve*

Raporti nuk ofron një analizë të impaktit që kjo normë interesi prej 9.05% ka në mënyrë afatgjatë mbi tarifat e konsumatorëve. Duke qenë se kjo praktikë mund të përsëritet edhe në të ardhmen, është e nevojshme që ZRRE të shqyrtojë implikimet afatgjata dhe të sigurojë transparencë lidhur me ndikimet potenciale në çmimet që konsumatorët paguajnë.

### **Rekomandimet e INDEP:**

INDEP rekomandon që ZRRE të marrë parasysh masat e mëposhtme për të adresuar këto çështje:

- **Të bëjë një rishikim të plotë** të premiumit prej 5.74% dhe të ofrojë një shpjegim të detajuar lidhur me metodologjinë dhe kriteret e përdorura për përcaktimin e tij, duke marrë në konsideratë edhe kushtet aktuale financiare në treg.
- **Të shqyrtojë opsione alternative më të favorshme** që do të mund të zvogëlonin kostot për konsumatorët, duke përfshirë mundësinë e rinegotimit të këtij premium apo aplikimin e mekanizmave të tjerë korrigjues më ekonomikë.
- **Të realizojë një analizë më të detajuar** mbi ndikimin afatgjatë që aplikimi i normës së tillë interesi ka në tarifat finale për konsumatorët, në mënyrë që të parandalojë rritjen e panevojshme dhe të pajustificuar të kostove për ta.

Në mungesë të këtyre ndërhyrjeve, konsumatorët mbeten të ekspozuar ndaj kostove financiare potencialisht të padrejta dhe të larta, si rezultat i aplikimit të një norme interesi që nuk është e qartë, transparente dhe e arsyetuar plotësisht.

### **Raport Konsultativ Përshtatjet vjetore të të Hyrave të Lejuara Maksimale për OSSH**

**Komenti 8: Mungesa e transparencës dhe qartësisë në justifikimin e kostove operative shtesë (OPEX) për katër komunat në veri të Kosovës dhe dobësitë në mekanizmin e monitorimit të këtyre kostove**

Në kapitullin mbi "Indeksimin e Kostove Operative dhe të Mirëmbajtjes, Zhvlerësimin të Lejuar dhe Kthimit të Lejuar në Kapital për vitin 2025", ZRRE ka miratuar kostot operative shtesë (OPEX) për OSSH-në në shumën prej **0.935 milionë €** për shërbimet në katër komunat në veri të Kosovës. Nga kjo shumë, **0.362 milionë €** lidhen me mirëmbajtjen e rrjetit dhe kyçjet e reja, ndërsa **0.573 milionë €** klasifikohen si "shërbime të tjera". INDEP ka disa vërejtje lidhur me transparencën, justifikimin dhe mekanizmat e monitorimit të këtyre kostove:

*1. Mungesa e transparencës në lidhje me natyrën specifike të "shërbimeve të tjera" (0.573 milionë €)*

Raporti nuk ofron detaje të qarta lidhur me përmbajtjen konkrete të këtyre "shërbimeve të tjera". Edhe pse këto shpenzime janë pjesë e kostove operative të lejuara, mungesa e një përshkrimi të qartë krijon paqartësi të konsiderueshme rreth nevojës dhe arsyeshmërisë së këtyre kostove.

*2. Paqartësitë në metodologjinë e kalkulimit të kostove operative shtesë*

Megjithëse raporti përmend se ZRRE ka bërë një analizë krahasuese mes kostove në veri dhe në pjesët e tjera të Kosovës, mungon një shpjegim konkret rreth metodës së kalkulimit të këtyre kostove operative shtesë. Nuk sqarohet nëse këto kosto janë bazuar në kontrata konkrete, marrëveshje specifike, apo janë supozime të bëra nga ZRRE, duke ngritur pikëpyetje mbi saktësinë dhe justifikimin e shifrës së aprovuar.

*3. Mungesa e referencave konkrete nga Marrëveshjet e Brukselit dhe dokumente të tjera relevante në dialogun Kosovë-Serbi*

Raporti përmend se kostot shtesë janë në linjë me "Udhëzuesin për Energji" dhe legjislacionin sekondar që rrjedh nga dialogu Kosovë-Serbi, por nuk jep citime konkrete apo referenca specifike nga dokumentet ose marrëveshjet e dialogut të Brukselit. Një lidhje më e qartë dhe më transparente midis këtyre kostove shtesë dhe detyrimeve të dala nga marrëveshjet në dialog do të ishte e nevojshme për të justifikuar plotësisht kalimin e këtyre kostove tek konsumatorët.

*4. Mungesa e një mekanizmi të qartë monitorues dhe verifikues të efikasitetit të këtyre kostove*

Megjithëse raporti thekson se OSSH ka mundësi teknike të monitorojë rrjedhën e energjisë në sistemin e shpërndarjes në veri, ai nuk ofron asnjë mekanizëm të qartë apo të detajuar për monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit të këtyre kostove operative shtesë. Pa një mekanizëm të tillë, konsumatorët mbeten të ekspozuar ndaj rrezikut që këto kosto të mos jenë plotësisht të justifikuara apo të optimizuara, duke rezultuar në tarifa më të larta të panevojshme.

## *5. Mungesa e analizës specifike se si këto kosto operative do të përkthehen në përfitime konkrete për konsumatorët*

Raporti thekson në mënyrë të përgjithshme se kostot operative shtesë do të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe në reduktimin e humbjeve, por nuk ofron asnjë analizë të detajuar apo specifike mbi mënyrën se si këto kosto (sidomos pjesa prej 0.573 milionë € për "shërbime të tjera") do të ndikojnë konkretisht në shërbimet për konsumatorët. Një mungesë e tillë e transparencës dhe detajeve analitike dobëson argumentin e ZRRE-së për kalimin automatik të këtyre kostove në tarifat e konsumatorëve.

### **Rekomandimet e INDEP:**

Për të adresuar këto probleme dhe për të rritur transparencën dhe mbrojtjen e konsumatorëve, INDEP rekomandon që ZRRE të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

- **Të ofrojë shpjegim të plotë dhe transparent** për natyrën specifike të "shërbimeve të tjera" prej 0.573 milionë €, duke specifikuar qartë çfarë shërbimesh përfshihen dhe arsyet pse janë të nevojshme.
- **Të publikojë metodologjinë konkrete të përdorur** për kalkulimin e kostove operative shtesë, duke përfshirë çdo kontratë, marrëveshje specifike apo supozim të përdorur për këtë kalkulim.
- **Të qartësojë lidhjen e drejtpërdrejtë të këtyre kostove operative me Marrëveshjet e Brukselit apo dokumente të tjera** nga dialogu Kosovë-Serbi, duke përmendur citime konkrete dhe referenca specifike.
- **Të krijojë dhe të implementojë një mekanizëm monitorues** për vlerësimin dhe verifikimin e efikasitetit të këtyre kostove operative shtesë, duke siguruar transparencë dhe optimizim të shpenzimeve.
- **Të kryejë analizë më të detajuar dhe specifike** mbi mënyrën konkrete se si këto shpenzime operative do të ndikojnë pozitivisht në shërbimet ndaj konsumatorëve në komunat veriore, por edhe në Kosovë në përgjithësi.

**Komenti 9: Mungesa e transparencës dhe analizës së mjaftueshme në përcaktimin e kostove dhe objektivave për humbjet e energjisë në nivel të OSSH-së, sidomos në komunat veriore**

INDEP konsideron se analiza dhe parashikimet e paraqitura në Kapitullin 2 të raportit ("Azhurnimi i parashikimit të kostos së lejuar të humbjeve (LSSCt) për OSSH për vitin 2025") shfaqin disa mangësi në transparencë dhe në aspektin e justifikimit ekonomik dhe metodologjik, sidomos në lidhje me trajtimin e komunave veriore dhe ndikimin që këto vendime mund të kenë tek konsumatorët.

Raporti në faqen 10 përmend se OSSH fillimisht kishte parashikuar humbje prej 49.50 GWh në komunat veriore, vlerë e cila më pas u rrit në 80.25 GWh. Përfundimisht, ZRRE propozon një vlerë të ndërmjetme prej 61.67 GWh. Ky ndryshim i madh në parashikim, pa një shpjegim të qartë mbi metodat dhe të dhënat e përdorura, tregon



mungesë të konsistencës në qasjen metodologjike dhe dobëson besueshmërinë e parashikimit.

Në lidhje me shpërndarjen e kostove, raporti nuk sqaron në mënyrë eksplicite nëse kostot më të larta të humbjeve në komunat veriore do të përballohen ekskluzivisht nga konsumatorët e këtyre komunave, apo nëse ato do të shpërndahen tek konsumatorët në pjesën tjetër të Kosovës. Pa një sqarim të tillë, mbetet e paqartë nëse do të ketë subvencionim indirekt (cross-subsidization), ku konsumatorët tjerë mbajnë një pjesë të barrës financiare për humbjet e larta në veri.

Gjithashtu, raporti (faqe 11-12) parashikon kostot e importit për mbulimin e humbjeve bazuar në çmimet nga HUPLEX dhe ALPEX, duke propozuar një çmim mesatar prej 96.07 €/MWh. Megjithatë, nuk është specifikuar një mekanizëm që do të përdoret për rishikim ose korrigjim në rast se çmimet reale gjatë vitit 2025 ndryshojnë ndjeshëm nga këto parashikime, sidomos duke marrë parasysh luhatjet e mëdha mujore (74.05 €/MWh deri në 180.30 €/MWh).

Përfundimisht, raporti (Tabela 7, faqe 13) propozon një kosto totale të lejuar për humbjet prej 86.652 milionë €, shumë më e ulët se kërkesa fillestare e OSSH-së prej 108.652 milionë €. Sidoqoftë, dokumenti nuk përmban një analizë të qartë afatmesme apo afatgjatë mbi mënyrën se si ndryshimet e kostove të humbjeve mund të ndikojnë në tarifatat përfundimtare për konsumatorët, gjë që do të ishte e domosdoshme për të siguruar stabilitetin dhe parashikueshmërinë në sektorin energjetik.

Për të adresuar këto çështje, INDEP rekomandon që ZRRE të ndërmarrë veprimet në vijim:

- **Të publikojë një shpjegim më të detajuar dhe transparent** lidhur me metodologjinë dhe kriteret e përdorura në përcaktimin e objektivit prej 21.5% të humbjeve në komunat veriore për vitin 2025.
- **Të sqarojë qartë ndarjen e kostove të humbjeve**, duke specifikuar në mënyrë transparente nëse konsumatorët në pjesët e tjera të Kosovës do të bartin pjesërisht koston e lartë të humbjeve në veri përmes njohjes së kostove ndaj operatorëve tjerë.
- **Të implementojë një mekanizëm korrigjues ose rishikim periodik** për kostot e importit të energjisë, duke mundësuar rregullim të drejtë në rast të ndryshimeve të çmimeve gjatë vitit.
- **Të përgatisë një analizë të hollësishme të ndikimit afatmesëm dhe afatgjatë** të këtyre kostove dhe objektivave mbi tarifatat finale për konsumatorët, duke mundësuar parashikueshmëri dhe stabilitet më të madh në tregun energjetik.

Në këtë mënyrë, ZRRE do të përmirësonte transparencën, drejtësinë dhe qëndrueshmërinë ekonomike të vendimeve të saj, duke mbrojtur interesat e konsumatorëve në të gjithë Kosovën.

**Komenti 10: Paqartësitë në Kalkulimin e MAR-it dhe Nevoja për Transparencë në Mbrojtjen e Interesave të Konsumatorëve**

Në kapitullin 4 të raportit, ZRRE propozon të Hyra të Lejuara Maksimale (MAR) për OSSH-në prej 181.574 milionë € për vitin 2025, që është dukshëm më e ulët sesa kërkesa fillestare e OSSH-së prej 217.770 milionë €. Megjithëse raporti thekson se ky reduktim synon të "sigurojë një ekuilibër të drejtë mes operatorit dhe konsumatorëve," mungon një analizë e qartë se pse ky ekuilibër nuk mund të jetë edhe më shumë në favor të konsumatorëve, për shembull, përmes një uljeje shtesë të kostove që mbarten automatikisht tek konsumatori.

Për më tepër, diferenca prej 7.446 milionë € në faktorin korrigjues të të hyrave (KREVT) midis propozimit të OSSH-së (33.610 milionë €) dhe atij të ZRRE-së (26.164 milionë €) nuk është sqaruar mjaftueshëm në raport. Nga perspektiva e konsumatorit, kjo mungesë transparence është problematike, pasi çdo llogaritje e paqartë e këtij faktori korrigjues mund të rezultojë në tarifa më të larta për konsumatorët sesa ato të justifikueshme.

Gjithashtu, diferenca prej 1.015 milionë € lidhur me detyrimet ndaj KOSTT-it mes propozimit të OSSH-së (3.585 milionë €) dhe atij të ZRRE-së (2.570 milionë €), edhe pse thuhet se vjen nga ndryshimet mes parashikimit dhe realizimit të konsumit në vitin paraprak, nuk detajohet sa duhet për konsumatorët. Një qasje e tillë e paqartë ngre dyshime nëse kostot e shtuara të propozuara nga OSSH janë vërtet të arsyeshme apo përfaqësojnë një transferim automatik të kostove tek konsumatori pa një kontroll të plotë mbi efikasitetin e këtyre kostove.

Mbi të gjitha, raporti nuk trajton mjaftueshëm ndikimet afatgjata mbi konsumatorët nga kjo strukturë e tarifave. Ulja e propozuar nga ZRRE, edhe pse duket në interesin e konsumatorëve në afat të shkurtër, nuk është e qartë nëse kjo ulje do të mjaftojë për të parandaluar rritje të mëtejshme tarifore në vitet në vijim. Konsumatorët kanë nevojë për një mekanizëm më të qartë dhe më transparent që të sigurohen se reduktimi i propozuar është maksimalisht i mundshëm dhe jo thjesht një kompromis që ende mund të rezultojë në kosto të pajustificuara në të ardhmen.

## **Përfundime dhe Rekomandime**

Në analizën e dokumenteve të konsultimit publik të paraqitura nga ZRrE, vihet re se ky proces mbetet i kufizuar vetëm në diskutimin e përshtatjeve teknike të të Hyrave të Lejuara Maksimale (MAR) për FSHU, OST/OT dhe OSSH, pa një propozim konkret lidhur me strukturën tarifore apo mënyrën specifike të shpërndarjes së shtrenjtimit tek konsumatorët. Gjithashtu, mungon transparenca mbi mënyrën si procesi i liberalizimit të tregut të energjisë ndikon konkretisht në këto tarifa.

ZRrE ka paralajmëruar një rritje mesatare prej rreth 15%, mirëpo nuk ka paraqitur asnjë propozim specifik për strukturën tarifore që do të reflektojë këtë rritje. Kjo qasje e pamundëson pjesëmarrjen e informuar të konsumatorëve dhe palëve të tjera në diskutimin publik, duke i privuar ata nga mundësia për të vlerësuar dhe komentuar në mënyrë efektive mbi ndryshimet që do të prekin drejtpërdrejt shpenzimet e tyre.

Procesi i liberalizimit, i shpallur në një moment kyç, pa një sqarim të plotë të ndikimit që kalimi i disa konsumatorëve në tregun e lirë do të ketë mbi tarifën për konsumatorët e mbetur, vazhdon të jetë i paqartë dhe arbitrar. Ky proces duhet të zhvillohet bazuar

në një manual të qartë metodologjik, me afate konkrete dhe pa shtyrje të përsëritura, duke mos u përdorur si mekanizëm për justifikimin e shtrenjtimit.

Në dokumentet e konsultimit të ofruara, mungojnë gjithashtu analiza të qarta afatmesme dhe afatgjata për implikimet që këto ndryshime tarifore do të kenë tek konsumatorët, si dhe detaje të mjaftueshme mbi metodologjinë e përdorur në llogaritjen e kostove të ndryshme.

Duke marrë parasysh këto përfundime, ne rekomandojmë:

- ZRrE të organizojë një konsultim publik të veçantë dhe të detajuar për çdo propozim konkret që lidhet me ndryshimin e tarifave energjetike dhe strukturës së tyre. Konsumatorët dhe palët tjera duhet të kenë mundësi reale për të komentuar para miratimit të çdo vendimi nga ana e Bordit të ZRrE-së.
- ZRrE duhet të sqarojë në mënyrë transparente dhe të detajuar se si procesi i liberalizimit të tregut do të ndikojë konkretisht në tarifën për konsumatorët e mbetur në shërbimin universal. Ky proces duhet të jetë i qartë, i parashikueshëm dhe i bazuar në hapa të mirëpërcaktuar, me një kalendar të qartë kohor të aprovuar dhe publikuar paraprakisht.
- ZRrE të ofrojë shpjegime të hollësishme mbi metodologjitë e përdorura për përcaktimin e kostove dhe të ofrojë mekanizma korigjues në rast se parashikimet devijojnë dukshëm nga realiteti gjatë periudhës së implementimit të tarifave të reja.
- Të shqyrtohet seriozisht ristrukturimi tarifor me blloqe konsumi që mbrojnë konsumatorët me konsum esencial deri në 600 kWh, duke e orientuar shtrenjtimin tek konsumatorët me konsum më të lartë. Kjo qasje është e domosdoshme për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm dhe për të nxitur kursimin e energjisë.
- ZRrE duhet të rrisë nivelin e transparencës dhe të përmirësojë mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të kostove që transferohen tek konsumatorët. Çdo kosto shtesë duhet të justifikohet në mënyrë transparente dhe të përcillet me mekanizma monitorues për të garantuar që barra financiare për konsumatorët është plotësisht e justifikuar dhe e kontrolluar.

**Ky punim u botua me mbështetjen e Fondit të vëllezërve Rockefeller. Përmbajtja e këtij dokumenti përfshirë opinionet e shprehura, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve të INDEP-it, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo bordit.**

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:

